



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

NJOFTIM PËR STUDIMIN E MATJES SË KOHËS

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në bashkëpunim me agjencitë e tjera ligjzbatuese, me mbështetjen e IFC pjesë e Bankës Botërore, planifikon të kryejë një **Studim për “Matja e kohës së procedurave në kufi për pikat kufitare tokësore, detare dhe terminaleve të brendshme më të ngarkuara”**. Matja e kohës, do të kryhet për të gjithë llojet e mallrave që do të kalojnë në procedurat kufitare, si më poshtë:

Në pikën kufitare detare (Porti i Durrësit):

- Për eksportin dhe importin e mallrave nëpërmjet portit të Durrësit.

Në pikat kufitare tokësore:

- Mallrat e eksportit, të cilët nga terminali i Tiranës, Fierit dhe Elbasanit kanë si mbërritje pikë kalimet kufitare Morinë, Qafë Thanë, Kapshticë, si dhe mallrat për eksport, të cilët eksportojnë ekskluzivisht drejt pikë kalimeve kufitare të sipër përmendura.
- Mallrat e importit, që kalojnë nëpërmjet pikë kalimeve kufitare Morinë, Qafë Thanë dhe Kapshticë, të cilat procedohen ekskluzivisht në Terminalin e Tiranës, Fierit, dhe Elbasanit.

Procedurat tranzite ndërkombëtare me ardhje ose destinacion pikë kalimet kufitare të Morinës, Qafë Thanës, Kapshticës dhe portit të Durrësit do të përfshihen në këtë studim.

Afate kohore: Matja e kohës do të kryhet gjatë periudhës nga data **12 nëntor deri më datë 18 nëntor 2018, në pikën kufitare detare të Durrësit, ato tokësoret dhe terminalet sic lartpërmenden.**

Gjatë periudhës së matjes kohore, një pjesë e ngarkesave për import / eksport / tranzit duhet të pajisen me një pyetësor për matjen e kohës.

Të gjitha autoritetet kompetente duhet të plotësojnë me informacionin e duhur fushat në këtë pyetësor lidhur me punën e tyre sipas ngarkesës, duke treguar kohën e saktë të fillimit dhe përfundimit të veprimeve individuale në procedurën e importit, eksportit apo tranzitit të mallit.

Të gjithë pjesëmarrësit në procedurat kufitare duhet të plotësojnë në mënyrë të ndërgjegjshme pyetësin dhe më pas duhet ta vënë atë në dispozicion të autoritetit tjetër kompetent ose përfaqësuesit të mallrave, të cilët janë të detyruar të plotësojnë pyetësin në vazhdim. Ky pyetësor monitoron të gjithë procesin e eksportit / importit / tranzitit të mallit.

Pyetësi i plotësuar merret në fund të procedurës sic vijon:

- për procedurat e importit në rrugë tokësore, merret i plotësuar në Terminalin e Tiranës, Fierit dhe Elbasanit ose në pikë-kalimet kufitare Morinë, Qafë Thanë dhe Kapshticë;
- për eksportet në pikë-kalimet kufitare, merret i plotësuar në Morinë, Qafë Thanë, Kapshticë dhe porti i Durrësit. Pyetësi i plotësuar merret në fund të procedurës nga autoriteti i cili kryen veprimin përfundimtar të procedurës me mallrat, në përputhje me hapat e pyetësit.

Për çdo njoftim shtesë për studimin e matjes së kohës, mund të kontaktoni Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me anë të adresës e-mail helpdesk@dogana.gov.al